

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

29.10.2024

Ora 14:41

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e listës së detajuar të dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

• Ilirjana NANO Kryetar

• Arens ÇELA Anëtar

• Dritan ÇAKA Anëtar

• Helga VUKAJ Anëtar

• Muharrem ÇAKAJ Anëtar

• Stafi KQZ Znj. J. Josifi, znj.P.Doçaj

Parti Politike: PS (znj. E.Xhina) PL (z.K. Kolndreu)

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, zyrtarë të administratës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në panelin e dedikuar për përfaqësuesit e partive politike është znj.Xhina, që më herët ka qenë e pranishme dhe ka paraqitur autorizimin përkatës. Zotëria?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

Z. K. Kolndreu, përfaqësues i PL: Kreshnik Kolndreu, përfaqësues i Partisë së Lirisë.

Znj. I. Nano: Po. Kemi një autorizim për z.Kolndreu?

Z. K. Kolndreu, përfaqësues i PL: Po e nderuar.

Znj. I. Nano: E keni? Mundemi? Nëse mund ta verifikoni ndërkohë ju lutem? Mund ta verifikojmë. Pra, ka autorizim.

Znj. P. Doçaj: Është autorizuar si përfaqësues nga kryetari i partisë.

Znj. I. Nano: Dakord, faleminderit! Kemi dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Në mbledhjen e sotme kemi për shqyrtim një projektvendim “Për miratimin e listës së detajuar të dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit, kolegë kemi diçka jashtë rendit të ditës? Jo, nuk ka! Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit. Lidhur me projektvendimin do doja nga znj. Josifi, Drejtore e Drejtorisë së Votimit nga Jashtë, një përmbledhje lidhur me përmbajtjen e projektvendimit dhe propozimin që na keni sjellë. Zonja Josifi!

Znj. J. Josifi: Ju faleminderit! E nderuar Kryetare e Komisionit Rregullator, të nderuar anëtarë! Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka përcjellë pranë jush në vlerësim, gjykimin tuaj, për miratim, projektvendimin “Për miratimin e listës së detajuar të dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Në mbështetje të nenit 20, pika 1,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

shkronja “dh” të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ të përgatitura nga administrata, për rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, si dhe në zbatim të nenit 25, pika 5, po të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet se zgjedhësi për t’u regjistruar në listën e zgjedhësve jashtë vendit do duhet të paraqesë një dokumentacion që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit, lista e të cilit përcaktohet me vendim të Komisionit Rregullator, kemi përgatitur këtë projektakt. Gjithashtu, në mbështetje të ndryshimeve më të fundit të Kodit Zgjedhor, për sa do të duhet të përgatisim kushtet dhe të marrim masa që të na mundësojnë votimin nga jashtë vendit. Ky projektvendim është i organizuar në tre krerë. Në kreun e parë të tij parashikohen rregullat të përgjithshme, janë në fakt referimet ekzaktësisht të ligjit, sa i takon dokumentacionit që paraqet zgjedhësi, për regjistrimin në listën e zgjedhësve. Në kreun II parashikohen rregullat që lidhen me listën e detajuar të dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësit. Në zbatim të nenit 25, pika 5 parashikohet detyrimi i zgjedhësit për të dorëzuar në këtë rast, ngarkuar në Platformën Elektronike të Regjistrimit, PER, gjatë procesit të regjistrimit një nga këto dokumenta që vërtetojnë qëndrimin e tij. Tashmë miratimi i rregullave për regjistrimin e këtyre zgjedhësve dhe përgatitjen e listës së tyre, është miratuar nga ana juaj, me vendimin tuaj nr.10, të datës 23 tetor 2024. Gjatë paraqitjes së kërkesës së zgjedhësit, për regjistrim në listën e zgjedhësve sipas rregullave të miratuara nga ky Komision që sapa citova, zgjedhësit do të duhet të ngarkojnë në PER, të paktën një nga dokumentat e listuar në këtë projektvendim. Janë parashikuar 9 lloje dokumentash, më lejoni t’i listoj: certifikatë pronësie ose dokument ekuivalent në shtetin e rezidencës ku provon pronësinë e banesës; vërtetim banimi ose dokument tjetër ekuivalent, i lëshuar nga organet shtetërore të vendit të rezidencës, ku përcaktohet adresa e banimit; kontratë qiraje ose hua

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

përdorje të banesës; kontratë kredie për blerje të banesës; kontratë furnizimi ose faturë të furnizimit me ujë në banesë; kontratë furnizimi ose faturë të energjisë (gaz ose elektrike) në varësi të llojit të energjisë në banesë; kontratë ose faturë të abonimit të shërbimit digjital të transmetimeve audio-vizive; kontratë ose faturë të ofrimit të shërbimit të internetit, telefonisë fikse, në banesë; dokument të lëshuar nga organi kompetent i shtetit ku ka vendbanimin, i cili vërteton qëndrimin e zgjedhësit në një institucion shëndetësor, kamp emigracioni apo tjetër të ngjashëm. Në zbatim të parashikimeve të nenit 25, pika 6 të Kodit Zgjedhor dhe të rregullave të përcaktuara nga ana juaj me vendimin e sipër cituar nr.10, të datës 23 tetor, pas miratimit të kërkesës për regjistrim të zgjedhësit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile do të bëjë regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, të adresës që ky shtetas ka deklaruar gjatë procesit të regjistrimit, në një rubrikë të veçantë në këtë regjistër elektronik. Në hartimin e këtij projektvendimi, për të qenë sa më shterues në listën e dokumentacionit e cila do të pranohej për të provuar adresën e shtetasit nga jashtë, ne kemi shqyrtuar disa modele të vendeve të rajonit e më gjerë, të cituara në relacionin shpjegues të këtij projektakti. Kemi marrë rastin e Italisë, Spanjës, Gjermanisë, Bosnje-Hercegovinës dhe kështu kemi ardhur me këtë listë në projektakt. Për sa më lart, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve brenda kompetencave të veta, gjithashtu në respektim të detyrimeve, afateve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, propozon për shqyrtim dhe miratim të Komisionit Rregullator projektvendimin “Për miratimin e listës së detajuar të dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Josifi! Atëherë çelim diskutimin në parim. Në këtë fazë, e kanë së pari fjalën anëtarët e Komisionit Rregullator, më tej

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

përfaqësues të partive politike. Kolegë dëshironi në parim, të thoni diçka? Unë dy fjalë do thoja në parim. Sikundër u relatua më herët, në datën 23 tetor janë miratuar rregullat për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, e përgatitjes së listës së zgjedhësve. Nga ana tjetër, sikundër e dimë, dokumentacioni që sot na prezantohet në një akt më vete, ka qenë pjesë e një projektvendimi, i cili është dërguar për konsultim që në 23 shtator. Më tej është parë e arsyeshme nga ana e propozuesit, në këtë rast të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, që në zbatim të detyrimeve që burojnë nga neni 25, pika 5 dhe 6 të Kodit Zgjedhor, të vijë një akt më vete. Padyshim miratimi i këtij projektvendimi ka rëndësi të veçantë sepse mbyllim, nëpërmjet miratimit të këtij projektvendimi, fazën e regjistrimit dhe përgatitjes së listës së zgjedhësve. Pra, zgjedhësi di çfarë do të bëjë në funksion të aplikimit dhe më tej të regjistrimit të tij. Nga subjektet, nga partitë politike, ka diçka në parim ju lutem? Nuk keni diçka në parim. Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit “Për miratimin e listës së detajuar të dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

Kolegë, kush është dakord?


Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me pesë vota pro.

Kalojmë në shqyrtimin pikë për pikë apo nen për nen të projektvendimit. Po z. Çakaj.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

Z. M. Çakaj: Atëherë, përpara se të kalojmë në shqyrtimin pikë për pikë të këtij projektvendimi, unë kisha dëshirë t'i drejtoja dy pyetje, me karakter informues, administratës dhe më pas në varësi të përgjigjes do bëj një parashtrim të shkurtër. Atëherë, paraprakisht konstatoj që është e disata herë që ne e kemi ngritur në mbledhje, mungesën e komunikimit dhe koordinimit me shoqatat e angazhuara në fushën zgjedhore. Në rastin konkret, në orën 14:13 minuta na ka ardhur një email nga shoqata KRIIK, përfaqësuesja e së cilës ndodhet këtu, me vërejtjet e sugjerime përkatëse. Tani, ka diçka që nuk funksionon, ose ju nuk i keni zbatuar porositë tona të lëna, pra t'i dërgoni aktin në kohën e duhur, në momentin që na dërgohet dhe ne, në rastin konkret na është dërguar, 4 ose 5 ditë para ose shoqata KRIIK nuk është korrekte dhe nuk tregon vërtetësinë, por nuk na ka rezultuar kështu. Kështu që, a ka mundësi të koodinoheni? Se nuk funksionon kjo mënyrë. Çdo mbledhje dy minuta para, dhjetë minuta para, mëngjesin e asaj dite na vjen një listë me sugjerime, të cilat ne patjetër i vlerësojmë, por kjo tregon mungesë koordinimi midis Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe shoqatave të cilat janë të interesuara t'i japin kontributin e tyre në fushën e zgjedhjeve. Keni një përgjigje për këtë situatë konkrete?

Znj. J. Josifi: Po. Në fakt, kur Komisioneri ka nxjerrë për konsultim publik projektvendimin, fillimisht të integruar për rregullat, për caktimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit, hartimin e listës së këtyre zgjedhësve dhe listën e dokumentacionit që provonte adresën, ka qenë një projektvendim integral, i cili është publikuar për konsultim publik në datën 23 shtator dhe i është dërguar po ashtu organizatave, si organizatave të shoqërisë civile, si medias, si partive politike, po ashtu dhe Komisionit Rregullator, për njohje paraprake, për konsultim publik. Gjithashtu është zhvilluar një takim online me përfaqësues nga

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

diaspora. Në atë takim online nga ana e Komisionerit, ne e kemi cituar. Madje organizata KRIIK vetë e citoi në mbledhjen tuaj të datës 18 tetor, që ishte pjesëmarrëse, me disa pyetje. Ndërkohë solli rekomandimet e veta përpara mbledhjes të datës 18 tetor, nëse ju kujtohet disa minuta më parë, para se mbledhja të fillonte, edhe në atë rast. Në ato rekomandime, ashtu sikundër mbledhja u shty sepse duheshin riparë, qoftë dhe në projektvendimin për rregullat e regjistrimit, po edhe lidhur me tekstin për dokumentacionin. Propozimi që erdhi nga Komisioneri për shqyrtim dhe në vlerësimin tuaj ndau atë projektvendim fillestar në dy projektvendime, pra duke nxjerrë më vete listën e dokumentacionit. Ndërkohë teksti i këtij projektvendimi është njësoj me atë të konsultuar publikisht nga ana e tij, më parë. Për të cilin organizata KRIIK solli rekomandimet e veta në seancën e datës 18, ndër të cilat kryesisht ishin për rregullat e regjistrimit, kishte dhe një rekomandim që lidhej me listën e dokumentacionit. Propozimi i Komisionerit për të vënë në lëvizje...

Z. M. Çakaj: Çfarë rekomandimi ishte me datën 18? Nëse e keni.

Znj. J. Josifi: Po e kemi. Atëherë është pika 5, ka paqartësi në lidhje me kriteret për miratimin ose jo nga KQZ-ja, të kërkesës së shtetasit për t'u regjistruar si zgjedhës në listën paraprake të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit, për të cilën përcaktohet afati 5 ditor i parashikuar në pikat 3, 4, dhe 5, të kreut IV, të projektvendimit. Në këtë kre të projektvendimit, në një pikë shtesë të tij, nr.6, konsiderohet e nevojshme, të parashikohet qartësisht se kur KQZ-ja mund ta rrëzojë kërkesën e shtetasit për t'u përfshirë në listën paraprake të zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit, në rastin kur të dhënat e identitetit të shtetasit janë të sakta dhe përputhen me të dhënat që KQZ ka për këtë zgjedhës. Nëse mbetet vetëm

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

verifikimi i dokumentit, adresës së shtetasit, atëherë duhet përcaktuar qartë se vetëm pasaktësia e këtij dokumentacioni mund të sjellë mospërfshirjen e shtetasit në listën e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit. “Është e natyrshme në këtë pikë”, shprehet KRIIK, “të parashikohet dhe të përcaktohet se si, në ç’mënyrë, me çfarë mjetesh si dhe se kush do të bëjë shqyrtimin dhe verifikimet e nevojshme, të dokumentit të dorëzuar, që përcakton adresën e vendbanimit të shtetasit.” Ky parashikim...

Z. M. Çakaj: Jo, s’ka nevojë, e qartë.

Znj. I. Nano: Zonja Josifi, domethënë këto janë pikërisht për projektaktin që ne e kemi miratuar.

Z. M. Çakaj: Jo, s’është vetëm për projektaktin, kjo është për listën e detajuar të dokumentacionit, për adresën.

Znj. I. Nano: Ashtu sikundër kolegu e tha, edhe unë do t’ju kërkoja që për projektvendimet e ardhshme që ne do të shqyrtojmë. Ju e dini që ne si Komision Rregullator na i dërgoni, po flasim për dërgimin zyrtar, se çështja e konsultimit është. Në momentin që na i dërgoni ne zyrtarisht, do t’ju lutesha të konsultoheshit me Sekretarin e Përgjithshëm, me Komisionerin që të vihen në dijeni, që në atë moment kur akti është dërguar zyrtarisht, pavarësisht se kur e shpallim ne mbledhjen. Vlerësojeni që në aktet e tjera, qëkur i dërgohet Komisionit Rregullator, zyrtarisht t’u dërgohet edhe të interesuarve, sepse nga ai moment derisa ne e shpallim, njoftojmë mbledhjen dhe zhvillojmë mbledhjen, mund të kalojnë dy ditë, tre ditë, pesë ditë dhe në çdo rast ne marrim dhe shqyrtojmë

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

projektvendimin e ardhur nga ju zyrtarisht. Ndryshimet, shtesat, pakësimet bëhen këtu në seancë. Pra, koleg është ajo që diskutuat? Dua të na i dërgoni dhe t'ua dërgoni dhe partive politike dhe shoqatave që në momentin që i dërgohet zyrtarisht edhe Rregullatorit.

Z. M. Çakaj: Së dyti, kishit...

Znj. H. Vukaj: Jo, në vijim të koleges. E falenderoj për konstatimin dhe në funksion të Kodit të Procedurës Administrative, çdo akt duhet të marrë vlerësimin apo draftakt ka procesin e tij të mëvetëm, që do të thotë në qoftë se të gjithë organizatave dhe çfarëdo lloj trupe tjetër të interesuar i është çuar për diskutim akti integral i datës 23, kjo nuk do të thotë që ata do të mbeten në vazhden e vlerësimin të atij akti dhe do të jenë po në vazhden e gjithë veprimeve dinamike tonat. Akti, ky draft, ky proces meriton të kishte pavarësinë e tij. Pra, vlerësimin e tij të dedikuar këtij akti, sepse ata nuk mund të hamendësojnë nëse është përsëri ai tekst apo është një tekst tjetër. Në të njëjtën kohë unë dua të di, nëse a ka pasur gjatë kësaj periudhe, në qoftë se kjo s'është bërë, që nga data 23, a ka pasur ndonjë feedback, konkretisht për listën? Me qëllim që të di se ku jeni bazuar ju, me qëllim që kjo mua të më japë më tej garancinë, që unë ta marr të mirëqenë, që kjo qenkërka lista shteruese, për të gjithë shtetasit shqiptarë që ndodhen jashtë, që mund të provojnë qëndrimin e tyre jashtë vendit etj., etj. Pra, unë dua një mjet garancie, që përveç se administrata është një trupë e kufizuar këtu, që mendon njësoj si ne. Ndoshta dhe s'e kemi eksperiencën e të qenit, me përvojë emigratore apo studentore jashtë apo çfarëdo lloj motivi. Më duhet të di, më duhet garanci personalisht mua, po vlerësoj dhe kolegëve, që pse duhet të fillojë me 1 dhe të mbarojë me 10. Pse mos të jenë 15, ose pse të mos jenë 7, ose 6? Në këtë kuadër,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

a keni marrë ju, a keni nxitur ju organizatat e vëna në lëvizje pikërisht për qëllim, realizimin e kësaj garancie kaq të madhe, e një të drejte kushtetuese? Pra, për këtë janë vënë në lëvizje, në emër të interesit publik që sot është jashtë dhe ne po përpiqemi që të realizojmë, të bëjmë të realizueshme të drejtën e tyre. A keni marrë ju dhe a i keni nxitur ju, ndërkohë që nuk e pamë për këtë akt veçanarisht dhe posaçërisht ta kishit bërë. T'i kishit nxitur, zotërinj të nderuar keni versione të tjera të dokumentacionit, i cili serviret në vende të ndryshme nga ku ju keni eksperiencë apo përvoja të caktuara? A i keni me shkrim këto? Sepse kjo do t'i shërbente konsolidimit të aktit dhe realizimit më së miri të asaj të drejtës suaj të votimit nga jashtë. Ndërkohë, unë do të vlerësoja personalisht, por që i shërben edhe integritetit të kësaj mbledhje edhe vendimarrjes në të njëjtën kohë, se në fund të fundit është garanci e disa palëve që përveç se KRIIK, nuk shoh prezencë këtu dhe më ka lindur dhe mua pikëpyetja. Unë do doja që ju posaçërisht t'i ftonit të gjithë organizatat, partitë politike që ndoshta s'janë sot prezent në sallë, që në qoftë se s'kanë mundësinë të jenë këtu prezent në sallë, të kenë lidhje në Zoom këtë mbledhje dhe mendimi i tyre do ishte shumë i vyer.

Znj. J. Josifi: Po i përgjigjem pyetjes së parë. Në fakt është e vërtetë, çdo listë dokumentacioni ndoshta do të mund të ishte më e gjatë në listim, apo më e shkurtër. Ashtu sikundër është për çdo shtet ka veçantinë e tij, në kuptim të dokumentetave që lëshon që mund të provojnë apo të justifikojnë adresën e një shtetasi, prandaj në relacion ne e kemi parashtruar metodologjinë që kemi përdorur. Pra, kemi marrë për referencë disa vende që aplikojnë votimin nga jashtë, çfarë dokumentash, për të provuar adresën, pranojnë ata nga shtetasit e tyre që gjenden jashtë. Burimi i informacionit zyrtar të marrë të marrë nga ana jonë, për vendet që unë ju përmenda është dhënë në relacion, edhe lista shtetuese e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

dokumentave të vendeve përkatëse, prandaj ne kemi ardhur me këtë listë si propozim, duke përfshirë gjithë dokumentat që kemi parë në këto modele. Te gjithë lista e dokumentacionit...

Z. M. Çakaj: Një sekond.

Znj. H. Vukaj: Pra, ekziston garancia që kjo është lista shteruese? Pra, kemi garanci në këtë pikë që kjo e shteron të gjithë kriterin, më provon vendqëndrimin, vendbanimin tënd jashtë, me qëllim regjistrimi, adresën që ti ke deklaruar?

Znj. J. Josifi: Nga modelet që kemi parë, ne nuk...

Znj. H. Vukaj: Pra, keni një ju një konfirmim të përtej administratës se çfarë propozon administrata, të atyre që merren nga mëngjesi deri në darkë me këtë proces, pra grupet e interesit, të përfaqësuar nga organizata të caktuara, të cilat i shikojnë në një këndvështrim ndoshta jashtë institucional.

Znj. J. Josifi: Siç ju thashë lista e këtij dokumentacioni që keni sot përpara, që nuk ka ndryshuar nga ajo e konsultuar që prej datës 23 shtator, është konsultuar me organizatat të shoqërisë civile që veprojnë në diasporë. Në takimin online nuk ka pasur as edhe një koment për të shtuar apo për të hequr një dokument nga kjo listë që ne kemi propozuar. Ka pasur propozime dhe nga organizatat vendase të cilat gjithashtu janë cituar në relacionin e projektaktit. Kështu taman thënë me fjalët e tyre, për të mundur, për të parë mundësinë për të përfshirë si dokument vetëdeklarimin, por nuk ka pasur as edhe një koment, sugjerim, rekomandim për të shtuar ndonjë dokument që nuk është në listën tonë apo për të hequr ndonjë nga

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

dokumentat që është në listën tonë në këtë projektvendim që ju keni. I vetmi feedback ka qenë ndoshta duhet konsideruar edhe vetëdeklarimi i shtetasit si dokument, edhe këtë e keni të parashtruar, ka ardhur zyrtarisht, patjetër me shkrim nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, nga Qëndresa Qytetare. Këto kanë qenë dhe nga diaspora shqiptare.

Z. M. Çakaj: Atëherë, në vijim të sqarimit tuaj, lidhur me pyetjen që shtroi kolegja Vukaj, në listën e dokumentacionit, i cili provon qëndrimin e shtetasit jashtë vendit. Së pari biem dakord të gjitha palët, besoj jemi të qartë që vendqëndrimi jashtë vendit është bërë për efekt dorëzimi dokumentacioni. Pra, dokumentacioni zgjedhor, atje ku do i shkojë zarfi i postës që KQZ-ja, së bashku me fletët e votimit apo fletën e votimeve apo dokumentacionin zgjedhor do t'i dërgojë zgjedhësit, i cili ka kaluar me sukses procesin e regjistrimit. Pra është në listën përfundimtare të zgjedhësve jashtë vendit, ky është qëllimi kryesor, ky është materializuar si nenin 25 të Kodit Zgjedhor, me ndryshimet e fundit, si dhe në aktin tonë të parë si dhe sigurisht në këtë akt. Unë paraprakisht vlerësoj që kjo listë këtu nuk është shteruese. Më lejoni t'ju përmend, t'ju citoj vetëm dy dokumenta. Në rastin konkret, nëse një shtetas shqiptar që ndodhet me banim apo ndodhet jashtë vendit dhe kërkon të votojë aty, në adresën e vetëdeklaruar në PER, pra në rubrikën e posaçme kërkon që ta marrë zarfin dhe deklaron një kuti postare, ndërkohë që rezidenca e tij ndodhet në një vend tjetër, por ky P.O Box është i tillë, dhe ai kërkon ta marrë në këtë adresë të vetëdeklaruar. Në rastin e dytë, varianti dy, mund të jenë pafund shteruese, nëse një shtetas shqiptar e ka të ndryshëm vendin e punës dhe zakonisht vendi i punës është i ndryshëm nga vendi i banimit dhe kërkon për një arsye subjektive të tij, kërkon që zarfi i postës së KQZ-së t'i shkojë në adresën e punës. Atëherë si do të bëhet procesi i verifikimit të vetëdeklarimit, sigurisht

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

edhe me dokumentacion dhe kush do të jetë struktura që do ta bëjë këtë? Unë personalisht këtë e konsideroj si një moment shumë thelbësor, i cili do duhej të ishte në këtë akt. Pra, garancitë e nevojshme që ky proces do të jetë objektiv dhe mundësisht që ky proces do të jetë i rregulluar me një akt, ndoshta dhe unë e gjej me vend, e kemi thënë, që ta materializojmë në këtë akt. Pra, procesin e verifikimit të vetëdeklarimit, shoqëruar me dokumentacionin provues dhe procesin e shterimit sa më shumë, se nuk mund të shterojnë të gjithë dokumentacionin. Nuk i gjej të materializuara në këtë akt këto dy pyetje që ju bëra. Në gjykimin dhe vlerësimin tim janë më se normale. Pra, nëse shtetasi me banim jashtë shtetit kërkon që ta marrë materialin zgjedhor së bashku me zarfin e KQZ-së, ta marrë në një P.O Box, ndërkohë që adresa është, vërtetimin e vendbanimit e ka diku tjetër. E njëjta gjë vlen dhe për vërtetimin e banimit, banon diku tjetër, provuar me dokumentacion provues, por zarfin kërkon ta marrë në punë, për arsye se rri shumë kohë në punë. Ndërkohë që dhe shërbimet postare atje, mund të mos e gjejnë kurrë, pasi ai nga ora 8 derin në orën 5 apo 6 pasdite, mund të jetë në punë dhe atje kërkon ta marrë zarfin. Atëherë çfarë do t'i kërkojmë në shtetasit shqiptar me banim jashtë shtetit? Do t'i kërkojmë një kontratë pune? Nuk është vërtetim rezidence dhe me logjikë, e logjikshme do të ishte që ai të ngarkonte një kontratë pune. Ai këtu e do, punon në filan shoqëri, në filan fabrikë ose në filan njësi, kompani. Atëherë cili do të ishte dokumenti dhe kush do të jetë struktura që do të bëjë përputhjen, verifikimin ndërmjet adresës së vetëdeklaruar dhe dokumentit. Ndërkohë që dokumenti mund të jetë tjetërkund shtetasi shqiptar e kërkon zarfin aty. Se si do të funksionojë? Pra, njesia përkatëse e KQZ-së e cila do të bëjë verifikimin konkret të dokumentacionit të ngarkuar, kush do të jetë? Se PER-i nuk e bën. Patjetër duhet të jetë një strukturë e posaçme, apo jo? Mund të kem një përgjigje, ju lutem?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

Znj. I. Nano: Ka zonja Xhina një ndërhyrje, pastaj mund të jetë zonja Josifi.

Z. M. Çakaj: Dakord.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Faleminderit! Në fakt po e bëj ndërhyrjen për një saktësim më tepër. Pasi për sa i takon diskutimit, që vendqëndrimi lidhet me vendin ku do t'i dërgohet zarfi zgjedhësit, nuk më qëndron shumë si argument sepse në aktin që ju miratuat dhe që ne ishim prezent në diskutimin. Kjo listë dokumentash që ne jemi prezent dhe ju kërkoni ta miratoni me akt të veçantë lidhet me një dokument që vërteton qëndrimin e shtetasit jashtë vendit, jo me adresën ku do t'i çohet zarfi. Pra, e kemi specifikuar fjalë për fjalë, themi "Shtetasi ngarkon në PER një dokument që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë" dhe lista e dokumentave, kjo listë dokumentash miratohet me akt të veçantë. Pra, lista e dokumentave lidhet me vërtetimin e faktit që qytetari, zgjedhësi jeton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Z. M. Çakaj: Jo nuk është ashtu znj. Xhina.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Kështu është, po e lexoj fjalë për fjalë...

Z. M. Çakaj: Nuk është ashtu sepse në...

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS : Më fal ta përfundoj...

Z. M. Çakaj: Po si? Dakord. Po së pari ju ftoj të shikoni relacioni që shoqëron ligjin është miratuar me datë 26 korrik. Së dyti nëse unë jam shtetas shqiptar, i cili

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

jam me vizë, ndodhem jashtë shtetit për 3 muaj, për 6 muaj, jam thjesht edhe me vizë turistike, po kërkoj që të drejtën time kushtetuese ta ushtroj nga jashtë vendit. Çfarë dokumentacioni duhet të ngarkoj unë? Vizën? Unë e kam të lirë në gjithë vendet Shengen. Po pra, po nuk është kështu.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS : Në vijim të diskutimit...

Z. M. Çakaj: Të jemi korrekt me faktet.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS : Korrekt jemi.

Z. M. Çakaj: Ajo çfarë është e rëndësishme...

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Jemi duke thënë të njëjtën gjë.

Z. M. Çakaj: Ajo që është parashikuar në aktin, në vendimin tonë nr. 10 është mot a mot, neni 25, pika 5 e Kodit Zgjedhor.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Shumë mirë, atë jemi duke thënë.

Z. M. Çakaj: Vendimi i ligjvënësit nuk është për të provuar qëndrimin që shtetasi shqiptar...

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Këtë kemi thënë.

Z. M. Çakaj: Jo, atëherë lexojeni në mënyrë integrale.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Në listën e dokumentacionit që shtetasi provon që është jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për këtë po e kërkojmë dhe pastaj jemi shprehur dhe për adresën ku kemi dhënë të gjithë të dhënat që ai duhet të hedhë në platformë lidhur me adresën.

Z. M. Çakaj: Lexoni me vëmendje nenin 25, pika e parë.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Mendoj që e kam lexuar me vëmendje.

Z. M. Çakaj: Lexoni me vëmendje dhe shprehja e vullnetit, pra ligjvënësi ka parashikuar që shtetasi që dëshiron të votojë nga atje ku banon shpreh vullnetin dhe regjistrohet në listë.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Po, ai është vetëdeklarimi i tij.

Z. M. Çakaj: Është vetëdeklarimi.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Po këtë jemi duke thënë, tani jemi në një fazë tjetër.

Z. M. Çakaj: Ligjvënësi ka parashikuar që një shtetas shqiptar, i cili do të votojë atje, do të kryejë këtë procedurë atje dhe do të votojë atje.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS : Po, sigurisht.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

Z. M. Çakaj: Këto janë dokumentacioni dhe procedura shtesë, prandaj duhet t'ua bëjmë sa më të thjeshtë, jo t'ua vështirsojmë.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS : Po sigurisht, me atë parim jemi të gjithë.

Z. M. Çakaj: Në mënyrë që ai ta ushtrojë këtë të drejtë kushtetuese se këtu e ka, së pari.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Sigurisht!

Z. M. Çakaj: Së dyti këtu ka një kontradiktë nëse ai, unë sapo jua dhashë kazusin. Një sekond të lutem...

Znj. I. Nano: Do të shtoj vetëm diçka.

Z. M. Çakaj: Po.

Znj. I. Nano: Unë ia dhashë fjalën znj. Xhina sepse kërkoi fjalën, thashë mos ka diçka për të cilën do të duhet të na jepte përgjigje Drejtoresha, znj. Josifi.

Z. M. Çakaj: Znj. Xhina më kundërshtoi mua, nuk është se dha qëndrimin.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Nuk ju kundërshtova, ju thashë që akti vërteton, i takon listës së dokumentave që vërteton qëndrimin.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

Znj. I. Nano: Znj. Xhina do t'ju lutesha qëndrimin tuaj deri në fund që pastaj të vijojmë.

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Po dhe jam dakord me faktin që lista nuk mund të jetë shteruese ose dhe jam dakord me këtë fakt, por thjesht ajo që unë dua t'i vë thelbin është që ne jemi duke folur për listën e dokumentave që vërteton qëndrimin e shtetasve jashtë vendit dhe jo për adresën se ku i shkon zarfi. Kaq kisha. Faleminderit!

Z. M. Çakaj: Po nëse një shtetas kërkon të votojë ku do t'i vejë zarfi pra se ka deklaruar adresë të ndryshme, nuk ka rëndësi se ku banon, rëndësi ka ku do t'i vejë zarfi. Ku e kemi thënë?

Znj. H. Vukaj: Ky është një moment tjetër znj. Xhina.

Z. M. Çakaj: Kur t'i vijë zarfi, kjo është lista e dokumentacionit.

Znj. H. Vukaj: Zonja Xhina, e nderuar! Ne duam të shterojmë pikëpyetjen e madhe që jep garanci të gjithë tryezës sonë që do votojë këtë akt. A janë shteruese këto dokumenta? A kemi një garanci mbi këtë shterim? Nga ana tjetër unë do të preferoja që t'i adresoj edhe njëherë pyetja, konkretisht për listën, të gjithë organizatave dhe partive politike nëse kanë ndonjë feedback. Në këndvështrim të organizatës KRIIK, e cila, siç lexoi znj. Josifi, ka ngritur që më herët, shqetësimin që kush është mjete i garancisë që mua më mban të sigurtë në linjën e objektivitetit dhe të ligjshmërisë, që këto dokumenta nuk do jenë selektive apo do bazohen në vullnetin individual të atij punonjësi që do t'i marrë në shqyrtim, po do ketë një

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

mjet garancie, pra duhet t'i garantojmë. Sot duhet të ishte idealja, që edhe në këtë draft të ishte mjeti i garancisë i inkorporuar, por edhe në këtë këndvështrim duhet adresuar një kërkesë ose mendim, opinion, pra të gjithë organizatat që si e mendojnë, për ta është i garantuar procesi i mos abuzimit me dokumentacionin që serviret për të vërtetuar.

Znj. I. Nano: Tani, propozoni që t'ju drejtojmë pyetje organizatave për këtë mjet garancie që po thoni, apo administrata të bëjë një vlerësim më të thellë?

Z. M. Çakaj: Së pari administrata të japë një përgjigje për ato dy rastet, dy kazuset.

Znj. I. Nano: Zonja Josifi.

Znj. J. Josifi: Ndërkohë kolegët më thonë se nuk kemi mundësinë që ta shohim se jemi në mbledhje por duke qenë që mbledhjet tuaja janë publike dhe transmetohen në kanal in përkatës në internet, me qasje të hapur për të gjithë. Ndërkohë disa përfaqësues të organizatave të diasporës po reagojnë edhe live me komente tani që jemi në mbledhje dhe thonë që ky projektvendim është, kjo listë dokumentacioni është konsultuar në takimin online dhe nuk ka pasur, thjesht për verifikimin tuaj kjo. Lidhur me pyetjen tuaj se një shtetas...

Z. M. Çakaj: Më fal, me këta përfaqësues a ka mundësi t'i kemi dhe ne prezent në mbledhje? Nuk është kjo listë, ky akt, nuk është për ne, ky është për gjithë shqiptarët. Pse mos të kemi dhe ne? Pse mos t'i kishim?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

Znj. J. Josifi: Patjetër që mbledhjet janë të hapura, janë publike dhe njoftohen të paktën një ditë para, ora e zhvillimit të mbledhjes, ku zhvillohet mbledhja, si dhe materialet e mbledhjes.

Z. M. Çakaj: Më fal, po ju reagojnë juve në laptop apo po e bëjnë publikisht? Po ta kemi pra këtë reagim.

Znj. J. Josifi: Kam relacionin. Reagojnë publikisht në faqen e facebook-ut, në kohën që transmetohet mbledhja.

Znj. H. Vukaj: Ideja është që publikisht duhet të ishte aty.

Z. M. Çakaj: Po shumë dakord, po t'i kemi, janë të ftuar, janë të mirëpritur të marrin pjesë në mbledhje.


Znj. J. Josifi: Po patjetër janë të ftuar, po nuk i detyrojmë dot të vinë. Sigurisht do të ishte e mira t'i kishim këtu.

Z. M. Çakaj: I ftojmë dhe virtualisht.

Znj. J. Josifi: Nëse ju dëshironi që të gjitha mbledhjet tuaja sa i takon procesit të votimit nga jashtë dhe më gjerë, kjo i takon Sekretares së Përgjithshme, të jenë edhe në takim online, patjetër.

Z. M. Çakaj: Patjetër, këto i shërbejnë procesit, këto janë akte që i vlejné gjithë shqiptarve.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

Znj. J. Josifi: Lidhur me listën e dokumentacionit, ne nuk kemi pasur, siç ju thashë komente konkrete për të shtuar, hequr apo ndryshuar ndonjë dokument nga lista që ne kemi sjellë, as nga partitë politike as nga organizatat e shoqërisë civile, as nga shtetas që jetojnë jashtë vendit. Sa i takon asaj që ju pyetët nëse mundet një shtetas të deklarohet që dua ta marr fletën e votimit, nëse e kuptova qartë në një P.O Box, që do të thotë...

Z. M. Çakaj: Ose në vendin e punës.

Znj. J. Josifi: ...i jap një numër të kutisë time postare, nëse është kjo pyetje? Në fakt kjo është ezauruar në vendimin e këtij Komisioni nr.10 “Për rregullat e regjistrimit” sepse ju, në kreu III, 2 “Regjistrimi në listën e zgjedhësve” pika 3, shkronja “c”, keni thënë “Plotëson adresën e banimit, e cila duhet të përmbajë të paktën këto të dhëna: shteti, kodin postar”, që do të ishte kodi i kutisë postare në këtë rast “qytetin, emërtesën e rrugës, numrin e banesës si dhe elemente të tjera të adresës nëse ka”. Pra, nëse dikush vlerëson se e pret zarfin me fletën e votimit në një kuti postare, gjithsesi do duhet të deklarojë të gjitha këto të dhëna të renditura në vendimin tuaj të para pak ditëve, pra nuk mundet thjesht të thotë një numër të kutisë postare, shtetin, por duhet të thotë të gjitha siç i listova.

Z. M. Çakaj: Shumë dakord! Në rastin...

Znj. J. Josifi: Të ndaloj të lutem te verifikimi, vetëm ta përfundoj përgjigjen. Prapë në këtë vendim, kreu IV, se lidhet edhe me rekomandimin e ardhur nga KRIIK, ose pyetjen më saktë, se mos kërkesa për regjistrim pranohet ose jo, vetëm

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

pas verifikimit të identitetit apo edhe të dokumentit. Në kreun IV të vendimit nr. 10, tuajin, “Shqyrtimi i kërkesave dhe regjistrimi i zgjedhësve nga jashtë vendit”, pika 2, shkronja “c”, thuhet: “Verifikohet nëse dokumentacioni, i cili vërteton adresën e deklaruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është në përputhje me kërkesat e parashikuara, në aktin përkatës të Komisionit Rregullator”. Sigurisht kjo shkronjë paraprihet nga shkronja “a” dhe shkronja “b”. Pra, “Verifikohet saktësia, përputhshmëria e të dhënave të zgjedhësit”; “b” “Verifikohet përputhshmëria e të dhënës biometrike, në mënyrë automatike” dhe mbetet të shihet dhe të vlerësohet nëse ky dokumentacion që vërteton adresën është në përputhje me aktin përkatës të Rregullatorit, që është ky projektvendim i propozuar përpara jush sot. Ne nuk e kemi parë të nevojshme të cilësojmë, në mënyrë të veçantë se kush e trajton këtë kërkesë sepse është e vetëkuptueshme, administrata e KQZ-së, njësia përkatëse që administron këtë proces, ashtu sikundër ndodh edhe për procesin brenda vendit, në faza të ndryshme të tij. Pra, në këtë rast do të ishte drejtoria përkatëse, Drejtoria e Votimit nga Jashtë. Përkatësisht në kreun e fundit të këtij projektvendimi thuhet: “Ngarkohet administrata e KQZ-së dhe institucione të tjera të ngarkuara me detyra nga ky vendim për zbatimin e tij”.

Z. M. Çakaj: Do më jepni një përgjigje shteruese nëse një shtetas shqiptar që jeton dhe banon, ndodhet jashtë vendit, në respekt të nenit 25, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ai shpreh vullnetin, dëshirën për të votuar nga atje dhe e kërkon, e regjistron ekzaktësisht me numër, me kod postar, me të gjitha, adresën e tij. Atë adresë ku ai punon, ku kalon pjesën më të madhe të ditës dhe aty kërkon të marrë zarfin. Kush do ta verifikojë, kush do ta shqyrtojë këtë kërkesë, që ju thatë Drejtoria e Votimit nga Jashtë dhe çfarë dokumentacioni duhet të sjellë ky shtetas? Unë nuk e gjej

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

këtu, në listën e dokumentave. Ma thoni dot? Kështu keni minimalisht 20%, 30% të zgjedhësve nga jashtë. Ma thoni dot sepse nuk ju përgjigjet pyetjes sime.

Znj. I. Nano: Z. Çakaj mundem vetëm një moment? Pastaj zonja Josifi.

Z. M. Çakaj: Dakord.

Znj. I. Nano: Atëherë kemi ligjin, kemi aktin e miratuar në datën 23, kemi dhe një projektvendim sot. Le t'i shohim në tërësi. Ju cituat nenin 25, pika 5 të ligjit, unë do të citoj nenin 25, pika 6 sepse duhet ta shohim në mënyrë integrale. Neni 25, pika 6, ligjvënësi ka përcaktuar: "Adresa e shtetasit që voton nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mbështetet në një nga dokumentat që paraqet në KQZ sipas pikës 5". Pra, pika 6 është e lidhur me pikën 5, thënë me fjalë të tjera, adresën do ta deklarojë sipas fushave, pra adresën që do ai të deklarojë. Pra, në qoftë se ai banon këtu, do deklarojë këtë banesë. Për këtë banesë sipas pikës 6, duhet ta mbështesë me dokumentacion. Pra, duhet mbështetur me dokumentacion adresa që e ka vetëdeklaruar. Jo një adresë e ndryshme, jo një adresë tjetër.

Z. M. Çakaj: E nderuar Kryetare! Ne nuk do rrimë skllav i teorisë, unë po e shtroj pyetjen praktike. Nëse një shtetas, emigrant shqiptar, jeton dhe banon në Romë, por punon në një kompani, fabrikë, 50 km, ikën në orën 6.30, të mëngjesit dhe kthehet në orën 8 të darkës. Nuk ka shërbim postar pas orës 8 të darkës, ta garantoj unë, meqë kam qenë dhe ca vite vetë në emigracion, nuk ka shërbim. Ka nga ora 8 deri në orën 5 maksimumi, ja deri në orën 7. Atëherë ky shtetas deklaron, është rezident në Romë por kërkon ta marrë zarfin, se qëllimi ky është, që ai të votojë, të marrë zarfin dhe ta kthejë mbrapsht. Kërkon ta marrë në adresën e tij të punës. Cili

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

do të jetë dokumentacioni që duhet të ngarkojë në PER për të marrë këtë zarf? Nuk e gjej.

Znj. J. Josifi: Nuk është e parashikuar në këtë projektvendim.

Z. M. Çakaj: Nuk është i parashikuar?

Znj. J. Josifi: Jo, ky rast nuk është i parashikuar.

Z. M. Çakaj: Nuk është i parashikuar. Pra, ne kështu mund të kemi 25%, 30% minimalisht. Kështu që unë gjykoj që ky akt, për të përpunuar të gjitha mundësitë shteruese, për të shfrytëzuar në mënyrë maksimale, t'u garantojë gjithë shqiptareve, do të duhet të paktën, në listën e dokumentacionit, të eksplorojmë, të marrim pak më shumë kohë, jo shumë kohë se dhe ne jemi me afat, të konsultohemi dhe me shoqatat, me organizatat partnere të cilat na ndihmojnë në hartimin e kuadrit legjislativ dhe ta plotësojmë. Kështu që ta vlerësojnë dhe kolegët këtë gjë.

Znj. I. Nano: Padyshim që çdo kërkesë, e çdo anëtari të Komisionit Rregullator do të duhet të adresohet në këtë rast nga administrata. Megjithatë unë po them mendimin tim personal, vetëm për një nga çështjet që ju diskutuat, jo për të gjitha. Për faktin që do duhet të përputhet ajo çka deklaron me atë dokument që ti e mbështet deklarimin, të paktën këtë kërkon ligji. Megjithatë në qoftë se nga administrata kërkohet ose duhet të merret më tepër kohë për të adresuar këto kërkesa të kolegëve, t'i japim kohë. Zoti Çakaj!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*


Z. M. Çakaj: Jo vetëm kaq, jo vetëm takim që sigurisht është i mirëpritur, por të eksplorojmë të gjitha mundësitë, lista e dokumentacionit që përfshin në mënyrë maksimale, shteruese nuk e bëjmë dot që të jemi objektivë, së pari kjo. Së dyti unë do të doja një narracion të qartë, të mënyrës, nuk është e mjaftueshme në vendimin nr.10 që ne e miratuar në datën 23, të mënyrës së procesit të verifikimit dhe strukturës që do të verifikojë këtë. Garancitë e verifikimit me objektivitet të kërkesave për regjistrim, të verifikimit të listës të dokumentacionit, që do të thotë, nëse kjo strukturë do të ketë nevojë, ta vlerësojmë, për një kuadër rregullator, për disa parime, për disa rregulla, për mënyrën. Nëse mjaftojnë ato çfarë kemi miratuar, dakord, por do duhet të përpunohet më shumë. Nëse nuk mjafton atëherë hajde të shikojmë se si t'i shërbejmë që të gjithë kësaj strukture, në mënyrë që të jetë sa më objektive shqyrtimi i këtyre kërkesave. Pra, përpunimi i një numri maksimal të dokumentacionit, shterues do të ishte ideale, nuk besoj se e arrijmë, të cilat do të provojnë qëndrimin jashtë shtetit dhe të cilat do të garantojnë votën e zgjedhësve nga jashtë vendit. Në kuadër të kësaj edhe takim me shoqatat e diasporës që na kanë ndihmuar dhe sigurisht struktura nëse ka nevojë për rregulla, parime, mënyra se si do të funksionojë.

Znj. J. Josifi: Mundet ta lëmë që nesër këtë takim virtual nëse është në rregull për ju? Në një orar pasdite për shkak të ndryshimeve të orarit që kanë ata, se dikush është në Kanada? Mund të propozojmë një orë nesër?

Z. M. Çakaj: Kur të doni, kur ta vlerësoni ju, kur ta propozoni.

Znj. I. Nano: E para një orë pasdite nesër për takimin me shoqatat e diasporës, për ata që do ta kenë të mundur, ku secili nga kolegët të ketë pyetjet e veta. Së dyti,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 29.10.2024*

lidhur me kërkesën e kolegut Çakaj, na thoni kohën që ju duhet, se ne me sa po shikoj nuk mund të vijojmë me diskutimin nen për nen, kur vlerësohet që duhen adresuar këto kërkesa. Kështu që unë do propozoja për kolegët mbylljen e mbledhjes sot.

Znj. H. Vukaj: Do shtoja vetëm diçka, që lashë dy detyra që janë në funksion të vlerësimit nen për nen. Pra t'i adresohet në mënyrë eksplicite të gjithë pjesëmarrësve të interesuar, si organizata politike ashtu dhe ato OJQ, fakti nëse kanë opinin eksplicit, pikërisht për këtë draftakt dhe në të njëjtën kohë si e mendojnë ato mekanizmin e garancisë për një vlerësim objektiv, të pavarur, të paanshëm, të dokumentacionit të servirur nga zgjedhësi nga jashtë, dakord? Faleminderit!

Znj. I. Nano: Atëherë nuk do të vijojmë me shqyrtimin nen për nen, do të mbyllim mbledhjen sot. Mbledhja e radhës do t'ju njoftohet me email. Kini parasysh dhe faktin që nëse do të kemi një draft, të konsultohet para se të na vijë ose në momentin që na dërgohet zyrtarisht të konsultohet edhe me palët e interesuara, sikundër thamë. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

